



Prishtinë, 3.10.2023

**Përgjigjet në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik
për
Shqyrtimin e tarifave të energjisë termike – Raporti për të Hyrat e Lejuara për NQ
Termokos – sezoni 2023/2024**

1. Hyrje

Në përputhje me kërkesat ligjore, me datë 18 shtator 2023, ZRRE ka nxjerrë në konsultim publik Draft Raportin për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për NQ Termokos për sezonin 2023/2024. Me këtë rast të gjithë palët e involvuara dhe publiku i gjerë janë ftuar për të dhënë komentet e tyre në këtë Raport. Gjatë konsultimit publik ZRRE ka pranuar komentet me shkrim nga NQ Termokos.

2. Përgjigjet në komentet e pranuar nga NQ Termokos

Koment 1: Kostoja e personelit

Sa i përket Kostos së personelit – ‘Puna direkte’, përllogaritja e pagave për sezonin 2023-2024 është bërë sipas gjendjes së shpenzimeve të pagave për vitin 2022 dhe duke u mbështetur në faktin që gjatë viti 2023, ndërmarrja ka bërë zgjerimin e rrjetit në lagjet e reja të qytetit, kjo ka ndikuar në planifikimin e rritjes së numrit të të punësuarve në departamentin e Prodhimit dhe Distributimit për menaxhimin e këtyre pjesëve.

Për shkak të zgjerimit të rrjetit në lagjen Mati 1, Kalabria, Arbëria dhe Qendër, është i domosdoshëm plotësimi i vendeve të lira me kuadrot e nevojshëm, inxhinierë dhe punëtorë të kualifikuar në departamentet e lartëcekura.

Bazuar në faktet e prezantuara, kërkojmë që të lejohet shuma prej 1,423,634 € e planifikuar nga NP” Termokos” Sh.A.

Skema organizative e ndërmarrjes do të rishikohet gjatë kësaj sezone, e cila parashihet të ndodhë për shkak të zgjerimit të rrjetit nëpër lagje të reja të qytetit, me ç’rat paraqitet nevoja e rritjes së numrit të të punësuarve në ndërmarrje, të cilët do të angazhohen në ofrimin e shërbimeve sa më kualitative ndaj konsumatorëve për shkak të shtimit të vëllimit të punëve si në: Departamentin e Furnizimit, Departamentin e Financave, Departamentin e Administratës, etj. Gjithashtu edhe Departamenti për Investime Kapitale, ende është në proces të rekrutimit të stafit. Stafi i këtij departamenti sipas skemës organizative përbëhet nga drejtori dhe 11 punonjës. Buxhetimi për stafin e këtij departamenti është bërë, për shkak se në rast të mosbuxhetimit rezulton në mosfinalizim të skemës organizative. Poashtu gjatë vitit 2023 Bordi i Ndërmarrjes ka aprovuar një rritje të pagave prej 10% për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes, andaj edhe parashikimi i shpenzimeve të koston së personelit "e ndryshme prej punës



direkte", ka ndikuar në rritjen e kësaj kostoje. Andaj, bazuar në sa u tha më lartë, ju lutemi që t'a rishikoni edhe njëherë vlerën e lejuar për kostoja e Personelit ('e ndryshme prej punës direkte'), dhe t'a apromoni vlerën prej 1,458,517 € të propozuar nga NP Termokos sh.a.

Përgjigje

Siç është theksuar edhe në Raportin e të Hyrave të lejuara, për koston e personelit – 'puna direkte' NQ Termokos ka planifikuar një rritje mjaft të madhe – rreth 13.5% të koston së personelit krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar (tetor 2022 – tetor 2023); ndërsa për koston e personelit – 'e ndryshme nga puna direkte' rritja e propozuar është rreth 12% krahasuar me realizimet. Lidhur me këtë fillimisht duhet theksuar se gjatë monitorimit të realizimeve në periudhat e kaluara, në vazhdimësi është konstatuar tejkalim i kësaj kostoje nga lejimet përkatëse në shqyrtimet tarifore. Konkretisht në sezonin e kaluar 2022/'23 për koston e personelit të angazhuar direkt në prodhim dhe shpërndarje mbi-realizimi ka qenë 27%, ndërsa për koston e personelit të angazhuar në menaxhim, administratë dhe shërbimet tjera të ndërmarrjes mbi-realizimi ka qenë 47%, që është një tejkalim i pajustificueshëm në raport me lejimet.

Në propozimin e kësaj kostoje NQ Termokos kryesisht ka dhënë arsyetimet e njëjta për rekrutim të stafit shtesë për shkak të shtimit të vëllimit të punëve si rrjedhojë e zgjerimit të rrjetit dhe shtimit të numrit të konsumatorëve, si dhe për një rritje të pagave për të reflektuar inflacionin. Sa i përket rekrutimit të stafit shtesë duhet theksuar se sipas informatave nga NQ Termokos ende deri më tani nuk ka pasur ndonjë plotësim të pozitave të reja me staf të rekrutuar, e gjithashtu nuk është hartuar dhe dorëzuar ndonjë plan i rekrutimit i cili do të paraqiste prioritetet në rekrutimin e stafit të ri për pozitat vakante, afatet kohore dhe arsyetimet përkatëse të rekrutimeve në përputhje me shtimin e operimeve të ndërmarrjes.

Për sa i përket rritjes së pagave për të reflektuar inflacionin, fillimisht duhet theksuar rritja e propozuar nga ndërmarrja nuk është bazuar në të dhënat zyrtare të agjencisë të statistikave. ZRRE ka përllogaritur normën mesatare të inflacionit në vend për periudhën janar 2022 – korrik 2023, që sipas të dhënave të ASK-së është 9.56%. Gjithashtu duhet potencuar se, përkundër faktit të një inflacioni evident në vend që vjen për arsye të rrethanave objektive ndërkombëtare, në sektorin publik nuk ka pasur rritje të pagave.

Duhet po ashtu të theksohet fakti i cili vlen në përgjithësi lidhur me kompetencat menaxheriale të ndërmarrjes në raport me rregullimin: Gjatë menaxhimit të afarizmit të ndërmarrjes menaxhmenti ka kompetenca ligjore të merr vendime që i vlerëson të nevojshme por të cilat jo-domosdoshmërisht mund të jenë të arsyeshme nga aspekti i rregullimit; në këtë kontekst Rregullatori gjithnjë kujdeset që vendimet e ndërmarrjes të mos ndikojnë në një ngarkesë shtesë për konsumatorët, siç paraqet në rastin konkret vendimi për rritjen koston së personelit gjegjësisht të pagave. Rregullatori gjithnjë kujdeset që për çfarëdo ngarkese shtesë konsumatorët të marrin si kundërvlerë një furnizim të mjaftueshëm dhe shërbim cilësorë.

Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se rritja e propozuar nga NQ Termokos e koston së personelit nuk është e arsyetuar dhe e justifikuar sa duhet. Konkretisht ZRRE vlerëson se shtimi i vendeve të punës duhet të jetë në përputhje të plotë me shtimin e operimeve të ndërmarrjes duke përmirësuar shërbimin publik dhe sjellë përfitime për konsumatorët. Për këtë ZRRE mbetet pranë qëndrimit të vet për shumën e lejuar të koston së personelit e cila paraqet një rritje që reflekton normën e inflacionit në vend.



Koment 2: Investimet nga donacionet – Projekti i MCC: Instalimi i matësve të energjisë termike

Vlera e paraqitur prej 8,791,731€ paraqet koston e realizuar prej 4,235,610 € dhe atë të planifikuar për realizim pas kohës kur kemi raportuar, sipas BOQ për pjesën e nënstacioneve termike. Prandaj kjo shumë nuk paraqet reflektim të drejtë të realizimit të kosotve të projektit. Deri në periudhën e raportimit, siç e kemi shpjeguar në përgjigjet e komenteve të ZRRE në aplikacionin për tarifa 2023/24, është realizuar projekti në vlerën prej 7,690,565.99€, me ç'rast ka rezultuar diferenca e perealizuar në vlerën prej 1,692,752.73 €.

Shuma prej 1,692,752.73 € është vlera e kontratës e mbetur e papërfunduar dhe përfshinë 1,384,372€ për furnizimin e pajisjeve dhe instalim, ndërsa 308,381€ janë shërbime të konsulencës.

Përgjigje:

Vlera e përlogaritur prej 8,791,731 € është përlogaritur nga ZRRE sipas të dhënave për realizimet të dorëzuar nga ju gjegjësisht nga PIU - NQ Termokos, dhe është vërejtur mos-përputhje me vlerën e kontratës të paraqitur po ashtu nga ju (9,315,170 €). Gjithashtu duhet ritheksuar se të dhënat nga ju përfshijnë edhe shtesat e projektit gjegjësisht kontratës – këto janë strukturuar dhe paraqitur nga ZRRE mjaft qartë në Raport – ku janë paraqitur sasisë fillestare të pajisjeve dhe pas shtesave e po ashtu edhe vlerat monetare pas shtesave për secilin pozicion.

Në këtë detajizim (shih fq. 17 të Raportit) sipas grupimeve të pajisjeve llogaritet se vlera e pajisjeve matëse, sistemit të leximit/faturimit dhe instrumentet e regjistrimit dhe kontrollit të të dhënave është 4,235,610 € - afërsisht me shumën e realizuar të konstatuar në Raportimin e monitorimit për sezonin e kaluar 2022/'23. Pra për këtë grupim të pajisjeve nuk vërehet ndonjë investim shtesë i cili duhet pranuar për këtë shqyrtim tarifor. Ndërsa, duke qenë se valvolat termostatike konsiderohen si asete të konsumatorëve, ashtu si në shqyrtimin e kaluar tarifor, nuk janë pranuar si investime të reja.

Për sa i përket çështjes së pronësisë së këtyre aseteve duhet ri-theksuar se, për pajisjet matëse ekziston përcaktimi ligjor i obligimit për instalim dhe të drejtës së pronësisë së ndërmarrjes në këto pajisje. Ndërsa valvolat termostatike konsiderohen si asete të konsumatorëve, e që paraqesin një pjesë të konsiderueshme të aseteve të planifikuara për investim. Kështu që duhet një përcaktim i qartë për pronësinë e aseteve në mënyrë që të saktësohet vlera e aseteve të investuar që do të regjistrohet në pronësi të NQ Termokos, e rrjedhimisht do të përfshihet në Bazën e rregulluar të aseteve (RAB) për llogaritjet e mëtejme të kostonë së kapitalit dhe përgjithësisht të hyrave të lejuara

Bazuar në konstatimet e lartë-përshkruara ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të paraqitura në Raportin Rregullativ për konsultim publik për vlerën e pritshme / parashikuar të realizimit të këtij projekti investiv.

Gjithsesi pas realizimit të projektit dhe vlerave të sakta të aseteve të instaluar dhe të regjistruara në pronësi të ndërmarrjes, do të bëjë korrigjimet dhe axhustimet përkatëse në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.



Koment 3: Investimet nga donacionet – Projekti i KfW: ‘Solar4Kosova’

Projekti “Solar4Kosova” është duke u sqarur, dhe së shpejti do të kemi kompaninë konsulente për këtë projekt. Është shumë reale që në pjesën e dytë të vitit 2024 do të kemi të zgjedhur edhe kontraktorët për projekt. Në këtë rast pagesat për paradhënje dhe për punë të realizuara deri në fund të vitit janë të pashmangshme. Prandaj, kërkojmë që ZRRE të shqyrtojë edhe njëherë këtë vlerë dhe të lejohet vlera prej 10 mil.€ e paraqitur nga Termokos.

Përgjigje:

Në vlerësimin e planifikimeve për këtë projekt, ZRRE i është referuar statusit aktual të këtij projekti të përshkruar detajisht në Raport (shih fq. 18) – pra konkludohet se projekti është në fazën përgatitore dhe të tenderimit për përzgjedhjen e kompanisë konsulente që pritet të finalizohet në shtator-tetor 2023. Bazuar në informatat nga projekti dhe praktikën e zakonshme të procesit të realizimit të projekteve, kompania konsulente e përzgjedhur më tutje do të përgatisë specifikacionin e tenderit dhe udhëheq procesin e përzgjedhjes së kompanisë për ekzekutimin e punimeve; planifikohet që procesi i përzgjedhjes së kryesit të punimeve të finalizohet në fillim të gjysmës së dytë të 2024, me ç’rast do të fillojë edhe ekzekutimi i punimeve.

Duke marrë parasysh statusin aktual të projektit dhe planifikimet përkatëse të përfundimit të fazës përgatitore dhe fillimit të punimeve, ZRRE vlerëson se shuma e propozuar prej 10 mil € për periudhën e shqyrtimit tarifar nuk reflekton realisht këto planifikime, si në aspektin e kohëzgjatjes ashtu edhe të vëllimit të punëve që mund të realizohen në këtë periudhë.

ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të veta duke ri-theksuar se shuma prej **2.5 mil. €** pasqyron një planifikim më realist duke ju referuar statusit aktual të projektit dhe parashikimeve për përfundimin e fazës përgatitore dhe të fillimit të punimeve.

Gjithsesi ZRRE do të përcjellë progresin e zhvillimit të këtij projekti dhe do të bëjë vlerësimet dhe përshtatjet e duhura në shqyrtimet e ardhshme tarifore.

Koment 4: Investimet nga donacionet – Projekti i EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i ko-gjenerimit

Sa i përket projektit për dyfishim të kapaciteteve, kompania konsulente ka filluar përpilimin e dizajnit konceptual. Një skenar optimist jep me kupto se edhe në këtë projekt, në vitin në vijim do të kemi lëvizje konkrete. Prandaj planifikimi i një buxheti prej 4 mil. €, është i domosdoshëm dhe kërkojmë që të rishqyrrohet vlera e pranuar nga ZRRE dhe të lejohet vlera e paraqitur nga Termokos prej 4 mil. €

Përgjigje:

Ky projekt është në fazën fillestare studimore në kuadër të IPA-s mbështetur nga EU dhe EIB (Banka Investive Evropiane në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e Prishtinës dhe NQ Termokos. Shuma e paraqitur e investimit është planifikuar për studimin e fizibilitetit dhe planin e dekarbonizimit, punët përgatitore e projektuese, dhe për fillimin e realizimit të punimeve.



Duke ju referuar statusit aktual të projektit (shih fq. 17-18 të Raportit) – faza studimore në përfundim e sipër, ndërsa ka filluar faza përgatitore dhe projektuese, ZRRE e vlerëson si jorealiste planifikimin e ndërmarrjes duke marrë parasysh kohëzgjatjen e zakonshme të fazës përgatitore dhe projektuese deri në ekzekutim të punimeve. Prandaj ZRRE mbetet pranë vlerësimit të vetë që për këtë periudhë të shqyrtimit tarifor, të pranojë vlerën prej 1 mil. € për këtë projekt investiv.

ZRRE do të përcjellë në vazhdimësi ecurinë e kësaj faze studimore të projektit dhe do të bëjë vlerësimet dhe përshtatjet e duhura në shqyrtimet e ardhshme tarifore.

Koment 5: Investimet bashkëfinancim në projektet e donatorëve – projekti aktual i KfW

Në kohën kur është aprovuar “Plani zhvillimor 2022/2031” vlera e projektit ka qenë 16 mil. €. Pas aprovimit të këtij Plani Zhvillimor, në vazhdimësi janë bërë ndryshime në projektin e KfW, me ç’rast ka ndërruar edhe vlera e projektit për rreth 3 milion euro. Ndryshimet që ka pësuar ky projekt, sipas statutit aktual që ka pasur, janë raportuar nga Termokosi qoftë në “Bilancin vjetor të energjisë 2023” të aprovuar nga ZRRE, gjithashtu dhe në Raportet e realizimeve për sezonin 2022/2023.

Totali i kompletit të projektit duke përfshirë tenderin T1, T2 dhe Konsulencën, është 18,735,042.00 €. Kontrata përfundon në janar 2024. Si donacion për këtë projekt nga Qeveria Gjermane dhe Qeveria e Luksemburgut përmes KfW-se janë mjetet në vlerë prej 10,616,143.64€, kurse pjesa tjetër prej 8,118,898.36€, mbulohet nga fondet vetanake të NP “Termokos” SH.A.

Këto rritje të kostove kanë ndodhur për shkak të ndryshimeve në teren nga koha e përgatitjes së projektit e deri te fillimi i punimeve, dhe ndryshimeve gjatë kryerjes së punimeve.

Siç ju kemi informuar, të gjitha ndryshimet janë bërë në bazë të rregullave të FIDIKUT, në bazë të të cilave janë nënshkruar kontratat. Të gjitha ndryshimet për punët shtesë i kanë konstatuar ekspertët e konsulencës në bashkëpunim me ekspertët e Termokosit, e të cilat janë aprovuar nga KfW-ja.

Vendimmarrja për punët shtesë dhe dokumentacionet përcjellesë, janë të evidentuara dhe faktuara në minuta të takimeve të rregullta javore, mujore dhe në raporte të rregullta periodike të projekteve, në të cilat marrin pjesë të gjitha palët e përfshira në projekt duke filluar nga KfW, Termokosi, Konsulenca dhe Kontraktorët.

Në e-mailin e datës 08.09.2023 ju kemi informuar se :

- *Sa i përket dërgimit të kontratave dhe pjesës financiare të projektit që financohet nga KfW, nuk lejohet të ndahet me palët e treta, sipas marreveshjes tripalëshe në mes KfW, Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ndërmarrjes Publike “Termokos” Sh.a. (Projekti-Agjencia Ekzekutive) e nënshkruar me 29 mars 2018 në mes palëve të lartëcekura.*

Në aplikacionin për tarifa të sez. 2023/24 është paraqitur përshkrimi në mënyrë të detajuar rreth vlerës së projektit :

a)Kontrata T-1, MZ ID 201667575 / Procurement No. 505734 Supply and Installation of Heat Storage, Thermal Substations, Chemical Water Treatment and SCADA.



Vlera e kontratës : 7,784,573.17 euro,

Vlera e kontratës pas shtesave: 8.4 milion€

Kontraktor: JV Brunata & ERGOTEM

Pagesa e kryer për këtë pako është :3,228,328.93 euro, ndërsa

Pa paguar janë : 5,171,671.00 euro. Punët e planifikuara që janë pjesë e projektit sipas Kontratës T-1, janë në vazhdim e sipër dhe duhet të përfundojnë me 12.01.2024.

Për periudhën raportuese, për kontratën T-1, planifikohet të realizohet vlera prej 5,171,671.00 euro.

b)Kontrata T-2, Project: “Improvement of District Heating System Pristina”, Contract 2 - supply and installation of DH pipes, BMZ ID 201667575

Vlera e kontratës: 4,349,630.52 €;

Vlera Totale e projektit, pas Shtesave të pranuar: 7.6 milion €

Kontraktor : ALL ZONE LLC

Pagesa totale e kryer për këtë pako është 6,229,946.57euro, ndërsa

Pa paguar janë : 1,370,053 euro.

Për periudhën raportuese (tetor 2023- tetor 2024) për T-2, planifikohet të realizohet vlera prej 1,370,053 euro.

c) Shërbimet e konsulencës për T1 Dhe T2 janë: 3,061,238.00 euro (kjo vlerë nuk është paraqitur në aplikimin për tarifa 2023/24).

Për Shërbimet e konsulencës për T1 dhe T2 të papaguara janë: 212,414.29 euro.

Sqarimet lidhur me Shtesat e projektit për kontratat T1 dhe T2 si dhe për shërbime të konsulencës, nga NP”Termokos në mënyrë të detajuar, janë paraqitur në dokumentin e dërguar në ZRRE “Raportet dhe dokumentacionet plotësuese lidhur me kërkesën e ZRRE për projektet zhvillimore të NP “Termokos”SH.A të paraqitura në Aplikacionin për Tarifa të ngrohjes për sezonin 2023/2024”, me sa vijon:

Projekti në total ka mbërri vlerën rreth 19 mil. Euro, ku si donacion janë mjete të Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë së Luksemburgut përmes KFW-se në vlerë prej 10,616,143.64€, kurse pjesa tjetër mbulohet nga fondet vetanake të NP “Termokos” SH.A si bashkëfinancues i projektit.

Totali komplet i projektit duke përfshi tenderin T1,T2 dhe Konsulencën, është 18,735.042€

Këto ritje të kostove kanë ndodhur për shkak të ndryshimeve në teren nga koha e përgatitjes së projektit e deri te fillimi i punimeve, dhe ndryshimeve gjatë kryerjes së punimeve.

Vetëm në lagjen Mati 1, janë shtuar 30 objekte të reja ku është dashtë të bëhet ndryshimi i projektit i cili ka pasë një kosto shtesë prej 1,168,184.08€.

Nga ky ndryshim kanë përfituar 30 objekte të reja të cilat janë kyçur në sistemin e ngrohjes me një sipërfaqe prej 169,615.08 m² me 2,455 njësi banesore.

Ky ndryshim ka ardhë si pasojë e ndërtimeve të shumta në atë zonë dhe kërkesave të konsumatorëve, të cilat kërkesa janë përkrahur edhe nga Komuna e Prishtinës e cila ka kërkuar të përfshihen të gjitha objektet në atë lagje në sistemin e ngrohjes qendrore të N.P”Termokos”Sh.a. Ky ndryshim është përkrahur edhe nga N.P ”Termokos”Sh.a , është përgatitur nga konsulencia dhe aprovuar nga KFW-ja.



Pastaj ndryshimi tjetër ka ndodhë edhe në lagjen Arbëria, po ashtu me kërkesë të Komunës së Prishtinës që të planifikohet zgjerim edhe për pjesën tjetër të Arbërisë, për shkak të ndërtimit të rrugëve në atë lagje dhe mos pasjes së mundësisë së intervenimit në të ardhmen që do të kishte një kosto shumëfish më të madhe, ku si rezultat i ndryshimit të projektit të cilën e kanë bërë ekspertët e konsulencës IC, është rritë diametri i gypit magjstral nga Kulla -ish Rilindja deri te Komuna e re e Prishtinës në lagjen Arbëria.

Si rezultat i këtij ndryshimi është rritur kapaciteti për vazhdimin e zgjerimit të rrjetit të ngrohjes në të ardhmen edhe për 5MW, ku do të kenë mundësi kyçeje edhe diku rreth 500,000 m² me rreth 7,500 njësi banesore. Kostoja e ndryshimit të projektit për këtë zonë është 799,611.20 €.

Po ashtu, ndryshim ka pasur edhe në kontratë për shërbimet e konsulencës për zgjatje të afatit deri në përfundim të projektit, ku kostoja e saj është 988,714.00€

Pastaj një kosto shtesë është bërë edhe për rehabilitim në vlerë 45,846.20€

Gjithashtu ndryshime të shumta të paparashikuara në teren janë bërë gjatë rehabilitimit të rrjetit(ku dihet se rrjeti është shumë i vjetër dhe ka qenë e domosdoshme të intervenohet) dhe në dendsifikim.

Kosto e punëve shtesë në rehabilitim është 619,443.53€

Kosto e punëve shtesë në dendsifikim është 236,844.18€.

Vlera e totale për dy pakot e projektit (T-1 dhe T-2) dhe për shërbimet e konsulencës, që planifikohet të realizohet për periudhën (15tetor 2023-15tetor 2024), është 6,754,139.00 euro. Kjo shumë duhet të paguhet nga NP"Termokos"SH. A. si bashkëfinancim, për shkak se fondet nga donacionet për këtë projekt kanë mbaruar.

Prandaj kërkojmë që të rishqyrtohet vlera e pranuar nga ZRRE ,dhe të lejohet vlera e paraqitur nga Termokosi prej 6,754,139.00€, për arsye se kjo shumë duhet domosdoshmërisht të paguhet nga N.P"Termokos" SH.A, pasi që ky projekt mbaron në muajin janar të vitit 2024.

Meqenëse ky investim kapital, është investim vetanak i Termokosit, mos pranimi i kësaj vlere nga ana e ZRRE-së do të ketë impakt shumë të madh në përcaktimin e tarifave për sezonin ngrohës 2023/24.

Përgjigje

Fillimisht duhet përmendur faktin se komenti i juaj kryesisht përmban të dhëna dhe informata që NQ Termokos ka dërguar tek ZRRE, gjatë procesit të shqyrtimit tarifor.

Duhet rikujtuar se në kërkesën shtesë të ZRRE-së të dt. 29 gusht 2023 për këtë projekt, ku ZRRE kërkuar shpjegime detajime dhe dokumente përkatëse për të dëshmuar arsyeshmërinë teknike dhe financiare të këtyre shtesave të investimit. Kjo për faktin se ky projekt ka qenë i përfshirë në planet e kaluara zhvillimore të NQ Termokos, të aprovuar nga ZRRE, si në vijim:

- Planifikimet fillestare të projektit në fazën përgatitore të projektit kanë qenë rreth 14 mil. €, shumë kjo që ka qenë e përfshirë në Planin Zhvillimorë 2019-2029 të aprovuar nga ZRRE;
- Në e Planin e azhurnuar zhvillimorë 2022-2031, gjithashtu të aprovuar nga ZRRE, shuma e planifikuar e investimit ka qenë 16 mil. €;



Për shkak se NQ Termokos nuk ka azhurnuar planin zhvillimorë për të paraqitur dhe arsyetuar shtesat e fundit, ZRRE ka bërë Kërkesën shtesë. Megjithatë NQ Termokos në përgjigjen ndaj kësaj kërkesë (dt. 8 shtator 2023), nuk ka paraqitur veçanërisht studimet respektivisht analizat e kosto-përfitimit për arsyeshmërinë teknike dhe financiare për shtesat (segment dhe instalimet shtesë të projektit); gjithashtu nuk ka dërguar dokumente përkatëse që dëshmojnë kontraktimin e vlerave monetare shtesë.

Në mungesë të këtyre tyre, ZRRE i është do t'i referohet vlerës së planifikuar të investimit në Planin e azhurnuar zhvillimorë 2022-2031 prej 16 mil. €. Nga kjo shumë ka zbritur vlerën totale të realizimeve të këtij projekti investiv sipas vlerave të konstatuara në Raportet e monitorimeve për periudhat e kaluara 2021/2022 dhe 2022/2023. Rrjedhimisht shuma e mbetur është pranuar dhe lejuar për këtë shqyrtim tarifar: periudha tetor 2023 – tetor 2024.

Gjithsesi, nën kushtin që këto shtesa të projektit do të përfshihen në azhurnimet e planit zhvillimor dhe po ashtu të paraqitet arsyeshmëria teknike dhe financiare së bashku me dokumentin e vlerave kontraktuale shtesë, ZRRE do të bëjë korrigjimet përkatëse në shqyrtimin e ardhshëm tarifar sipas konstatimeve të realizimeve të këtij projekti.

Koment 6: Investimet bashkëfinancim në projektet e donatorëve – projekti aktual i MCC

Në kuadër të bashkëfinancimit prej 1 mi. €, NP Termokos Sh. a, do të mbulojë investimet për projektin e instalimit të matësve individual të energjisë termike në pjesët e lagjeve të cilat nuk janë mbuluar nga projekti aktual, dhe atë në këto lagje të qytetit:

Mati 1- 140 objekte, Lakrishta – një pjesë e objekteve që nuk janë të përfshira në kuadër të projektit aktual, dhe një pjesë e "Rrugës B"

Në bazë të Marrëveshjes trepalëshe në mes Komunës së Prishtinës, NP "Termokos"Sh.A , dhe MCC, bashkëfinancimi prej 1 mi. € nga ana e Termokosit, do të financojë pjesën e objekteve të lartcekura. Gjithashtu Termokosi ka ndarë në buxhetin e vitit 2023 vlerën e bashkëfinancimit prej 1mil. Euro për këtë projekt.

Meqenëse projekti i MCC mbaron në janar të vitit 2024, duhet që domosdoshmërisht të paguhet vlera e ndarë si bashkëfinancim nga NP"Termokos"Sh.A.

Kështu që, kërkojmë që ZRRE t'a pranojë vlerën e paraqitur nga Termokos prej 1 mil.euro, si bashkëfinancim për këtë projekt.

Përgjigje

Për shumën e paraqitur të bashkëfinancimit në këtë projekt, ju keni dhënë vetëm një informatë të shkurtër ku thuhet se kjo shumë e planifikuar do të përdoret për blerje dhe instalim të matësve të energjisë termike si shtesë nga projekti aktual.



Pra nuk keni dhënë asnjë informatë apo të dhënë tjetër, si p.sh. numrin e matësve, numrin e banesave gjegjësisht të konsumatorëve, numrin dhe lokacionin e ndërtesave e tjera detaje që janë të nevojshme për një vlerësim meritore të investimit të propozuar. Gjithashtu nuk është sqaruar nëse ky investim do të jetë në kuadër të kontratës aktuale për blerjen dhe instalimin e matësve të ngrohjes.

Për shkak të paqartësive që janë krijuar nga mos-përputhja e të dhënave lidhur me realizimin punëve instaluese (përgjigja më lartë), si dhe në mungesë të të dhënave dhe informatave bazike, ZRRE mbetet pranë qëndrimit të shprehur në Raport, se nuk e pranon këtë bashkëfinancim për këtë shqyrtim tarifor.

Koment 7: Investimet bashkëfinancim në projektet e donatorëve – projekti EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i ko-gjenerimit

Për Projektin EU-EIB për dyfishimin e kapaciteteve të ekstraktimit të energjisë termike nga sistemi i kogjenerimit, NP "Termokos" Sh.A. ka zotuar mjetet në shumën prej 2.5milion € për 5 vite, nga 0.5milion € në vit. Sa i përket këtij projekti, kompania konsulente ka filluar përpilimin e dizajnit konceptual. Një skenar optimist jep me kuptim se edhe në këtë projekt, në vitin në vijim, do të kemi lëvizje konkrete. Prandaj planifikimi i një buxheti prej 500,000 €, është i domosdoshëm, andaj kërkojmë që ZRRE ta pranojë vlerën e paraqitur nga Termokosi.

Përgjigje

Fillimisht duhet përmendur se për këtë planifikim të bashkëfinancimit nuk është paraqitur specifikisht ndonjë e dhënë apo informatë.

Duke ju referuar informatave që ZRRE posedon lidhur me statusin aktual të këtij projekti (shih komentin më lartë), ZRRE mbetet pranë vlerësimit se ky propozim për bashkëfinancim është i parakohshëm dhe për këtë nuk e pranon shumën e propozuar për periudhën një vjeçare të këtij shqyrtimi tarifor.

Koment 8: Investimet e reja me vetë-financim – Ndërtimi i objektit të NQ Termokos

Lidhur me investimet e reja me vetë-financim, konkretisht për ndërtimin e objektit të zyrës qendrore dhe administrative të NQ Termokos ka dërguar disa komente si në vijim:

- *Objekti ku aktualisht është i vendosur stafi administrativ i Termokosit është objekt shumë i vjetër, i cili është ndërtuar para shumë viteve dhe nuk i plotëson kushtet elementare për punë. Gjithashtu problem shumë madhor paraqet hapsira jo të mjaftueshme për kryerjen e detyrave të punës, për shkak të rritjes së numrit të stafit administrativ në NP "Termokos". Prandaj, nevoja e realizimit të një projekti për ndërtimin e një objekti të ri në hapsirat e njëjta të NQ Termokos ka qenë e padiskutueshme dhe imediate.*



Fillimisht për shkak të buxhetit të limituar të ndërmarrjes, është planifikuar ndërtimi i objektit të ri dhe përgaditja e planit ideor, në vlerë prej 530,000 € me sipërfaqe 1000 m² ose mbindërtim në objektin e vjetër (paraqitur në Planin zhvillimor 2019-2029).

Mirëpo, me hartimin e projektit detal ka ndërruar koncepti i ndërtimit të objektit duke rritur dukshëm përmasat e objektit dhe etazhitetin (specifikat e projektit ua kemi dërguar në raportimet e mëparshme), që natyrisht ka rezultuar me një vlerë dukshëm më të madhe se vlera fillestare e paraparë, për koston e ndërtimit të objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse ku vlera e këtij projekti ka arritur në 2.2mil.€ dhe mbikqyrja e ndërtimit të objektit 70,000€ (të paraqitura në Planin Zhvillimor 2022/31- i aprovuar nga ZRRE).

- Sa i përket rritjes së vlerës së investimit, siç ju kemi informuar në raportimet e kaluara, arsyeja qëndron se, buxheti i ndarë për realizimin e projektit për ndërtimin e objektit të ri administrativ, fillimisht ka qenë 2.2milion euro, mirëpo pas shpalljes së tenderit “Ndërtimi i objektit dhe renovimi i hapësirave përcjellëse”, oferta me çmimin më të lirë ka qenë në vlerë rreth 2,433,000.00 euro. Siç ju kemi raportuar në Aplikimin për tarifa 2023/24, gjatë procesit të tenderimit Autoriteti Kontraktues- NP “Termokos” sh.a, ka pranuar 3 oferta, prej të cilave 2 oferta kanë qenë brenda buxhetit të ndarë nga Autoriteti Kontraktues (AK), mirëpo kanë qenë të papërgjegjshme, ndërsa oferta e tretë ka qenë më e lartë se vlera e ndarë nga AK, me ç’rast AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Pas kësaj, AK ka pranuar ankesë nga OE për këtë aktivitet të prokurimit, prandaj AK ka dorëzuar kërkesën për interpretim ligjor pranë KRPP-së lidhur me ofertën që ka tejkaluar vlerën e mjeteve të ndara nga AK. Më pas kemi pranuar përgjigje nga KRPP-ja se mund të rritet vlera e mjeteve të ndara/alokuara nga AK përmes aprovimit nga ZKA dhe ZKF.

Prandaj, NP “Termokos” sh.a, ka alokuar mjete shtesë në vlerë prej 234,000.00 euro për të mbuluar vlerën e projektit. Shuma e mjeteve të ndara për këtë projekt përfshinë periudhën buxhetore 2023-2024.

Lidhur me mos realizimin të projektit gjatë periudhës së kalur, siç ju kemi informuar problemi ka qëndruar tek zgjatja në vazhdimësi e procedurave të prokurimit për shkak të ankesave të operatorëve ekonomik në OSHP dhe nga mungesa e Bordit të OSHP.

Ndërsa, sa i përket realizimit të projektit “Ndërtimi i objektit objektit të ri administrativ, dhe renovimi i hapësirave përcjellëse”, në raportimet e fundit lidhur me projektet zhvillimore të ndërmarrjes, ju kemi informuar se:

- Për këtë projekt është nënshkruar kontrata me datë 28.07.2023 me grupin e operatorëve; “Limit Projekt Sh.p.k., Delta projekt Sh.p.k. dhe Rinesa Sh.p.k.- Gllgovc. Vlera e kontratës është 2,433,753.60 euro. Kontrata ka hyrë në fuqi me datë 08.08.2023, ndërsa përfundon me datë 08.02.2025. Projekti zgjatë 18 muaj.
- Punimet për realizimin e këtij projekti kanë filluar menjëherë pas hyrjes në fuqi të kontratës. Deri më tani janë kryer punimet për lirim të hapësirës për ndërtimin e objektit të ri, me ç’rast janë larguar dy rezervuarë të mazutit, është rrënuar objekti që ka shërbyer si punëtori e Dep. të prodhimit dhe stacioni për ngohjen e mazutit (i cili duhet të vendoset diku tjetër).
- Aktualisht është duke u bërë largimi i dheut nga vendi ku do të fillojë ndërtimi i objektit.



Informatat kryesore lidhur me kontratën për ndërtimin e objektit .

Kështu që vlera e lejuar nga ZRRE për këtë investim me mjete vetanake të ndërmarrjes prej 482,000€, gjatë periudhës (tetor 2023- tetor 2024) është jshtëzakonisht e ulët, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kontratës.

Prandaj, meqenëse kjo vlerë investive me vetfinancim nga NP"Termokos"sh.a është shumë e rëndësishme në përcaktimin e tarfiave 2023/24, ju lutemi që të bëni rishikimin e kësaj vlere dhe të lejoni vlerën e planifikuar nga NP Termokos"sh.a prej 2,443,000€.

Përgjigje:

Ashtu siç është përshkruar edhe në Raportin për konsultim publik, ZRRE ka dhënë vlerësimet përkatëse të cilat, ndërlidhur me komentet e lartë-përshkruara, përmbliidhen si në vijim:

- Sa i përket realizimit të këtij investimi duhet thënë se, për disa sezone të kaluara rresht për këtë investim janë lejuar mjete por nuk ka pasur ndonjë realizim për shkak të vonesave në përgatitjen dhe zhvillimin e projektit. Specifikisht në shqyrtimin tarifor për sezonin e kaluar 2022/'23 ZRRE ka lejuar vlerën prej 482,000 €, e cila vlerë gjatë kësaj periudhe nuk është realizuar fare për shkak të vonesave në procesin e tenderimit.
 - Me hartimin e projektit detal ka ndërruar koncepti i ndërtimit të objektit duke rritur dukshëm përmasat e objektit dhe etazhitetin, që ka përfshirë edhe punime shtesë dhe kjo natyrisht ka rezultuar me një vlerë dukshëm më të madhe se vlera fillestare e paraparë e investimit për këtë projekt. Gjithashtu duhet përmendur se projekti i ndërtimit të objektit administrativ është përfshirë në Planin zhvillimorë afatgjatë në vlerë prej 530,000 €. Po ashtu duhet theksuar një dukuri, që në vazhdimësi nga sezoni në sezonë vërehet rritja e vlerës së parashikuar për ndërtim të objektit – nga vlera fillestare prej 550,000 €, në sezonin e kaluar është parashikuar vlera prej 1,350,000€, ndërsa në këtë sezon vlera e parashikuar ka arritur në 2,320,000€.
- Lidhur me këtë, ZRRE dëshiron të theksoj se ndryshimet përkatëse të investimeve paraprakisht të aprovuara duhet të jenë mirë të arsyetuara dhe të argumentuara.

Duke ju referuar përgjigjeve më lartë dhe sidomos ecurinë e deritanishme të këtij projekti gjegjësisht ngecjen e deritanishme në realizim, ZRRE qëndron pranë vlerësimeve të veta për vlerën e lejuar të investimit për ndërtimin e objektit të ri administrativ. Konkretisht shumën e lejuar në shqyrtimin e kaluar prej 482,000 € e bartë në shqyrtimin aktual tarifor për sezonin 2023/2024.

Përgatitur nga DETG, ZRRE